



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1476 prot.

Elbasan, më 04.06.2024

VENDIM

Nr. 34, datë 04.06.2024

**PËR SHPALLJEN E APLIKIMEVE PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI PËRFAQËSUES TË  
FAKULTETIT EKONOMIK DHE NJË ANËTARI PËRFAQËSUES TË FAKULTETIT TË  
SHKENCAVE TË NATYRËS, NË KOMISIONIN E APELIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT  
“ALEKSANDËR XHUVANI”**



Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrin e MAS nr.101, datë 13.03.2024 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë”, nenin 37, pika 2 e Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Senati Akademik,

**Vendosi:**

1. Të shpallë hapjen e procesit të aplikimeve për zëvendësimin e një anëtari përfaqësues të Fakultetit Ekonomik dhe një anëtari përfaqësues të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në Komisionin e Apelimit në Univesitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
2. Të drejtën për të aplikuar në Komisionin e Apelimit e kanë individët që janë anëtarë të personelit akademik të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 vjet, me kohë të plotë;
  - b) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
3. Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve për aplikim, do të jetë data 05.06.2024, ora 15.00.
4. Të interesuarit duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Senatit Akademik ose zyrës së Protokollit dokumentacionin e aplikimit sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Univesitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Skender TOPI**



## FLETË APLIKIMI

### PËR

### ANËTARË TË KOMISIONIT TË APELIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

Në zbatim, të nenin 37, pika 2 të Rregullores së zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024 unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të \_\_\_\_\_, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, paraqes aplikimin tim për të qenë anëtar i Komisionit të Apelimit pranë Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Në zbatim të nenit 37 pika 2 deklaroj se nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe as për anëtar në organet drejtuese të çdo niveli, si dhe përmbush kriteret e mëposhtëme;

- a- Kam përvojë pune në mësimdhënie, mbi 5 vjet, me kohë të plotë
- b- Nuk kam qenë asnjëherë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;

Bashkëlidhur dokumentacioni i mëposhtëm:

- a- Vërtetim punësimi në UE;
- b- Kopje e dokumentit të identifikimit

**Aplikanti/ja**

---

Emër, Atësia Mbiemër Firmë